



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1326 Prot.

Shkodër, më 01.04. 2026

**V E N D I M**

Nr. 108, datë 01.04 2026

**"PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS NË UNIVERSITETIN E SHKODRËS  
"LUIGJ GURAKUQI"**


Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, gërma d); Statuti i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", dhe neni 17, pika 6, gërma r); Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 01.04.2026:

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Kodit të Etikës në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha njësitë përbërëse në USH, për njohjen dhe zbatimin e dispozitave të këtij Kodi.
3. Shfuqizimin e Kodit të Etikës në USH, të vitit 2009.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT**

**Prof. dr. Tonin GJURAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

KODI I ETIKËS  
NË  
UNIVERSITETIN E SHKODRËS  
"LUIGJ GURAKUQI"

Prill, 2026

## KREU I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### NENI 1

##### Baza ligjore

Ky Kod hartohet në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit dhe Rregulloreve të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Ligjit nr.9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", si dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat rregullojnë çështje të etikës në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.

#### NENI 2

##### Qëllimi i Kodit të Etikës

1. Ky Kod ka për qëllim:
  - a. të përcaktojë një kuadër normativ për çështjet e etikës në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale në Universitetin të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (më poshtë referuar shkurtimisht "USH").
  - b. të vendosë rregulla të sjelljes dhe të përgjegjësive ligjore, profesionale dhe etike të autoriteteve drejtuese të USH-së, të personelit akademik dhe joakademik, si dhe të studentëve, sipas standardeve të vendosura në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe etike të universitetit dhe me lirinë akademike.
  - c. të garantojë integritetin në kërkimin shkencor, duke ruajtur, garantuar dhe mbrojtur integritetin akademik, profesional, institucional dhe etik të veprimtarisë akademike e kërkimore-shkencore në USH-së, në përputhje me standardet ndërkombëtare bashkëkohore të veprimtarisë akademike dhe të kërkimit shkencor;
  - d. të rregullojë organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi.

#### NENI 3

##### Fusha e zbatimit

1. Kodi i Etikës zbatohet në fushën e veprimtarisë institucionale, akademike, kërkimore shkencore, ndihmësakademike, administrative dhe studentore në USH. Kodi i Etikës zbatohet gjatë veprimtarisë në USH, nga i gjithë personeli akademik kërkimor shkencor, ndihmësakademik dhe studentët e USH-së.
2. Ky Kod ka përparësi ndaj rregulloreve të tjera të USH-së, vetëm për atë sa rregullon çështjet e etikës në veprimtarinë institucionale në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor në USH".

## NENI 4

### Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë Kod kanë kuptimet si më poshtë:

- a. "Integritet" do të thotë ndershmëri, korrektesë, drejtësi e besnikëri kundrejt punës dhe institucionit.
- b. "Fabrikimi" është sajimi i rezultateve të kërkimit dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta.
- c. "Falsifikimi" është manipulimi i materialeve, pajisjeve dhe/ose proceseve të kërkimit, ndryshimi, heqja a shmangia e të dhënave ose e rezultateve, në mënyrë të pajustificuar ose prezantimi i një punimi ose botimi si me vlera shkencore, pa qënë i tillë.
- d. "Plagjiatuarë" është përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve si të vetat, pa cituar burimin origjinal, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.
- e. "Veprimtaria akademike" është veprimtaria mësimdhënëse e kërkimore që zhvillohet në institucione të arsimit të lartë dhe ato kërkimore.
- f. "Infrastukturë bazë" është çdo burim, pronë, pajisje që shërben për zhvillimin e procesit akademik dhe kërkimor.
- g. "Infrastukturë ndihmëse" është çdo gjë që përdoret në funksion të zhvillimit të procesit akademik dhe kërkimor.

## KREU II

### PARIME TË PËRGJITHSHME

## NENI 5

### Liria akademike dhe kërkimore

1. Në USH respektohet liria akademike dhe kërkimore.

2. Liria akademike dhe kërkimore garantohet nëpërmjet së drejtës:

- a. për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese;
- b. për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- c. për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.

3. Veprimtaria akademike dhe kërkimi shkencor zhvillohen në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim negativ mbi kërkimin dhe rezultatet e tij.

## NENI 6

### Përgjegjshmëria dhe integriteti

1. Në USH çdo lloj veprimtarie ushtrohet me përgjegjshmëri dhe integritet.

2. Çdo individ që ushtron veprimtari në USH duhet të reflektojë një standard të lartë të integritetit personal e profesional, duke zbatuar kuadrin ligjor përkatës, për t'u siguruar që veprimtaria të kryhet në mënyre transparente dhe të përgjegjshme.

3. Personeli i USH-së duhet të përmbushë detyrat me kompetencë dhe paanshmëri, duke zbatuar standarte të larta profesionale në kryerjen e punës dhe duke mbajtur përgjegjësi për vlerësimet e bëra dhe materialet e përgatitura.

## **NENI 7**

### **Barazia dhe mosdiskriminimi**

1. USH garanton trajtim të barabartë për të gjithë personat, si brenda komunitetit universitar, ashtu edhe në marrëdhëniet me palët e tjera.
2. USH ka detyrimin për të shmangur çdo veprim apo mosveprim që krojon baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

## **NENI 8**

### **Përgjegjësia individuale dhe llogaridhënia**

1. Sjellja etike është një përgjegjësi individuale.
2. Individët që ushtrojnë veprimtari në USH duhet të marrin përsipër përgjegjësitë që lidhen me rolin dhe pozicionin e tyre në këtë Universitet. Ata janë përgjegjës për të gjitha veprimet e tyre dhe duhet të veprojnë me ndershmëri në kryerjen e detyrave që u janë ngarkuar”.
3. Personeli i USH-së, gjatë kryerjes së detyrës duhet të udhëhiqet nga parimi i përpikmërisë, korrektësisë, ndershmërisë, mirësjelljes, vullnetit të mirë, bashkëpunimit, solidaritetit, moralit të lartë dhe objektivitetit.

## **NENI 9**

### **Mbrojtja e informacionit, fshehtësisë dhe sigurisë**

1. Çdo individ që ushtron veprimtari në USH, është i detyruar të respektojë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë veprimtarisë në USH dhe të mos e përdorë një informacion të tillë për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat është marrë informacioni, gjithmonë duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **NENI 10**

### **Përdorimi i përgjegjshëm i fondeve, infrastrukturës bazë dhe ndihmëse**

1. Çdo individ që ushtron veprimtarinë në USH, ka të drejtën të përdorë fondet, infrastrukturën bazë dhe ndihmëse të USH-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë në USH me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
- 1.2. Çdo individ që ushtron veprimtarinë në USH ka detyrimin të përdorë me kujdes dhe të mos keqpërdorë fondet, infrastrukturën bazë dhe ndihmëse të USH-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

2. Nuk lejohet që personeli i USH-së, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi të përdorë apo të lejojë që të përdoren fondet, infrastruktura bazë dhe ndihmëse e USH-së, si dhe dokumentacioni zyrtar i USH-së për qëllime të tjera të ndryshme nga kryerja e detyrës.

## NENI 11

### Shmangia e konfliktit të interesit

1. Rastet e konfliktit të interesave janë përcaktuar në ligjin nr.9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave, në ushtrimin e funksioneve publike", Kodin e Procedurave Administrative si dhe në Rregulloren përkatëse të Konfliktit të Interesit të miratuar në USH.

2. Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të personelit të USH- së, në të cilën ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

3. Çdo anëtar i personelit të USH-së duhet të shmangë konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin e tij privat.

4. Në çdo rast që krijohen rrethana në të cilat ushtrimi i detyrës konsiderohet se krijon kushte për konflikt interesi, duhet të njoftohet me shkrim eprori, Sektori i Burimeve Njerëzore, apo autoriteti përgjegjës për konfliktin e interesave në institucion sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative dhe legjisllacionit në fuqi.

## NENI 12

### Sjellja dinjitoze personale dhe respektimi i mjedisit të punës

1. Çdo individ që ushtron veprimtarinë në USH duhet të ketë një sjellje të mirë dhe të denjë në të gjitha rrethanat, me qëllim respektimin e etikës profesionale dhe të ligjit gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

2. Çdo individ që ushtron veprimtarinë në USH duhet:

a. Të ruajë një paraqitje serioze përpara studentëve dhe personave të tjerë gjatë orarit të punës, që përfshin veshje serioze e dinjitoze, përdorimin e një fjalori të zgjedhur dhe brënda normave të etikës e të sjelljes qytetare.

b. Të mos lejojë që marrëdhëniet personale të çënojnë marrëdhëniet profesionale.

c. Të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime nga studentë apo persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve të larta, apo favore të tjera për shkak të detyrës.

d. Të mos bëjë dallime ndër studentë, vartës apo kolegë për shkak të njohjeve apo preferencave personale.

e. Të trajtojë në mënyrë të barabartë vartësit, kolegët dhe studentët, duke shmangur cënime të dinjitetit, të personalitetit dhe të mendimeve të tyre profesionale.

f. Të trajtojë kolegët (qofshin këta eprorë, të barabartë apo vartës) me mirësjellje dhe respekt.

g. Të shmangë në ambientin e punës ato sjellje që krijojnë atmosferë jomiqësore apo frike.

h. Të mos konsumojë pije alkoolike gjatë ushtrimit të detyrës.

i. Të respektojë dhe të zbatojë me efektivitet orarin e punës, duke e shfrytëzuar atë vetëm për kryerjen e detyrave që lidhen me pozicionin e punës.

### **KREU III**

## **PARIMET E ETIKËS GJATË VEPRIMTARISË AKADEMIKE, NDIHMËSAKADEMIKE, ADMINISTRATIVE DHE STUDENTORE**

### **NENI 13**

#### **Parimet e etikës gjatë veprimtarisë akademike**

1. Në USH veprimtaria akademike ushtrohet në kuadrin e përgjegjshmërisë akademike e shkencore dhe shërben si bazë e vlerësimit të performancës së personelit akademik.

2. Në USH personeli akademik duhet:

a. që lirinë akademike ta mbështesë mbi standarde shkencore dhe profesionale; në respekt të të drejtave të të tjerëve dhe sipas etikës profesionale.

b. të realizojë me performancë të lartë kërkimin shkencor, mësimdhënien dhe praktikën.

c. të kryejë detyrat akademike, shkencore ose në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, në përputhje me Statutin dhe rregulloret e USH-së;

d. Të veprojë në përputhje me aktet e brendshme të USH-së dhe legjislacionin në fuqi.

e. Të zbatojë etikën dhe të ruajë imazhin e institucionit dhe figurën profesionale.

f. të respektojë dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të studentëve dhe personelit të USH-së.

3. Në USH personeli akademik nuk mund të penalizohet për shkak të opinionëve të tij ndaj politikave të institucionit. Pavarësisht opinionëve të tij ndaj politikave të institucionit, në të gjitha rastet, personeli akademik vepron brenda normave të etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

### **Neni 14**

#### **Parimet e etikës në veprimtarinë ndihmësakademike**

1. Në USH veprimtaria ndihmësakademike ushtrohet në kuadrin e përgjegjshmërisë akademike e shkencore dhe shërben si bazë e vlerësimit të performancës së personelit ndihmësakademik.

2. Në USH personeli ndihmësakademik duhet:

- a. që lirinë akademike ta mbështesë mbi standarde shkencore dhe profesionale; në respekt të të drejtave të të tjerëve dhe sipas etikës profesionale.
  - b. të realizojë me përformancë të lartë mësimdhënien dhe praktikën.
  - c. të kryejë detyrat akademike në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, në përputhje me Statutin dhe rregulloret e USH-së;
  - d. Të veprojnë në përputhje me aktet e brendshme të USH-së dhe legjislacionin në fuqi.
  - e. Të zbatojnë etikën dhe të ruajë imazhin e institucionit dhe figurën profesionale.
3. Në USH personeli ndihmësakademik nuk mund të penalizohet për shkak të opinionëve të tij ndaj politikave të institucionit. Pavarësisht opinionëve të tij ndaj politikave të institucionit, në të gjitha rastet, personeli ndihmësakademik vepron brenda normave të etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

#### **Neni 15**

##### **Parimet e etikës në veprimtarinë administrative**

1. Në USH veprimtaria administrative ushtrohet në kuadrin e përgjegjshmërisë institucionale dhe shërben si bazë e vlerësimit të performancës së personelit administrativ.
2. Në USH personeli administrativ duhet:
  - a. të realizojë me përformancë të lartë detyrat administrative.
  - b. të kryejë detyrat administrative, si dhe mbështetjen institucionale ndaj të tretëve, në përputhje me Statutin dhe rregulloret e USH-së;
  - d. Të veprojnë në përputhje me aktet e brendshme të USH-së dhe legjislacionin në fuqi.
  - e. Të zbatojnë etikën dhe të ruajë imazhin e institucionit dhe figurën profesionale”.
3. Në USH personeli administrativ nuk mund të penalizohet për shkak të opinionëve të tij ndaj politikave të institucionit. Pavarësisht opinionëve të tij ndaj politikave të institucionit, në të gjitha rastet, personeli adminiostrativ vepron brenda normave të etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

#### **Neni 16**

##### **Parimet e etikës gjatë veprimtarisë studentore**

1. Në USH veprimtaria studentore ushtrohet me integritet dhe përgjegjshmëri.
2. Studentët kanë për detyrë të respektojnë dispozitat e këtij Kodi dhe aktet e brendshme të USH-së, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit.
3. Në USH studenti mban përgjegjësi për veprimet e tij, gjatë kohëzgjatjes së studimeve të tij në USH.
4. Në USH studentët kanë detyrimin:

- a. Të respektojë rregullat e mësimit, në zbatim të Statutit dhe rregulloreve të studimeve në USH.
- b. Të paraqiten në mjediset e USH-së mënyrë serioze, me veshje të përshtashme, jo ekstravagante dhe të përdorin një fjalor të përshtatshëm sipas normave të etikës dhe të mirësjelljes.
- c. Të respektojnë dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të studentëve të tjerë dhe personelit të USH-së;
- d. Të mos kryejnë veprime dhe gjeste provokuese apo ngacmuese ndaj personelit të USH-së apo studentëve të tjerë, në mjediset e institucionit;
- e. Të mos kopjojnë në provime, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, të mos kopjojnë në punën kërkimore-shkencore të dikujt tjetër;
- f. Të mos konsumojnë pije alkoolike apo duhan në mjediset e institucionit;
- g. Ta mbajnë të fikur celularin gjatë provimit apo orarit të mësimit.
- h. Të mos dëmtojnë mjediset e USH-së.
- i. Të mos fabrikojnë apo të publikojnë të dhëna të pavërteta, në përmbushjen e detyrimeve akademike ose që çënojnë imazhin e USH-së.

5. Në USH studentët kanë të drejtë:

- a. Të jenë të mbrojtur nga çdo lloj diskriminimi, në mbështetje të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.
- b. Studentët kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, të mbledhjes dhe grupimeve për aq kohë sa shfrytëzimi i këtyre lirive pajtohet me misionin e USH-së.
- c. Studentët janë të lirë të organizohen dhe marrin pjesë në organizata studentore, për të promovuar interesin e tyre të përbashkët brënda institucionit. Organizatat studentore janë të lira të shqyrtojnë dhe diskutojnë të gjitha çështjet e interesit, në përputhje me Statutin e USH-së dhe aktet të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

## **KREU IV**

### **PARIMET E ETIKËS GJATË VEPRIMTARISË KËRKIMORE**

#### **NENI 17**

##### **Parimet e etikës gjatë kërkimit shkencor**

1. Parimet themelore të integritetit të kërkimit orientojnë kërkuesit në punën e tyre dhe angazhimin e tyre ndaj sfidave praktike, etike dhe intelektuale që shoqërojnë ose burojnë nga kërkimi shkencor.

2. Parimet e etikës gjatë kërkimit shkencor janë:

- i. shmangia e plagjiaturës
- ii. ndershmëria në zhvillimin dhe në komunikimin e rezultateve me transparencë, drejtësi dhe paanshmëri;
- iii. respekti për kolegët,
- iv. kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin;
- v. përgjegjësia profesionale dhe shoqërore për kërkimin;

## NENI 18

### **Sjellja e përgjegjshme në veprimtaritë kërkimore**

1. Në USH kërkuesit janë të angazhuar në arritjen e standardeve më të larta në kërkimin shkencor, si dhe në arritjen e standardeve profesionale.
- 1.2. Në USH kërkuesit bëjnë kujdesin më të madh të mundshëm për mënyrat dhe procedurat e analizës, të dokumentimit dhe të formulimit të rekomandimeve të kërkimit shkencor.
- 1.3. Në USH rezultatet, interpretimet, përfundimet dhe rekomandimet e kërkimit shkencor publikohen të qarta, me saktësi e transparencë, duke respektuar fshehtësinë e të dhënave apo të gjetjeve kur kjo është e nevojshme ose kur kërkohet.

## NENI 19

### **Respektimi dhe masat mbrojtëse në kërkimin shkencor**

1. Në USH kërkuesit veprojnë në përputhje me kodet dhe rregulloret e disiplinave përkatëse të fushave të studimit.
- 1.2. Në USH kërkuesit i trajtojnë subjektet e kërkimit me kujdes e respekt dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe etike në fuqi.
- 1.3. Në USH kërkuesit tregojnë kujdes maksimal për shëndetin, sigurinë integritetin dhe mirëqënien e komunitetit, të bashkëpunëtorëve dhe të personave të tjerë që marrin pjesë ose që janë të lidhur me kërkimin.
- 1.4. Në USH kërkimi shkencor duhet të respektojë ndjeshmëritë që lidhen me diferencat moshore, gjinore, seksuale, kulturore, fetare, etnike, ekonomike, financiare dhe sociale midis komuniteteve, individëve, bashkëpunëtorëve dhe të personave të tjerë që marrin pjesë ose që janë të lidhur me kërkimin.
- 1.5. Në USH kërkuesit shmangin rreziqet dhe dëmet e mundshme që kërkimi mund të shkaktojë mbi komunitetet, individët, mjedisin, trashëgiminë historike e kulturore, si dhe perspektivat e zhvillimit në territorin ku kryejnë studimet.

## NENI 20

### **Përdorimi dhe ruajtja e të dhënave kërkimore**

1. Në USH personeli akademik dhe kërkimor sigurojnë që qasja në të dhënat të jetë e hapur sa më shumë të jetë e mundur: e gjetshme, e arritshme, ndërvepruese, transparente, e ripërdorshme. Qasja në të dhënat mund të kufizohet aq sa vlerësohet e nevojshme, me qëllim që të ruhen të dhënat sensitive.
- 1.2. Në USH personeli akademik dhe kërkimor prodhojnë të dhëna dhe produkte legjitime dhe të mundshme për t'u cituar, në bazë të standardeve të citimit.

1.3. Në USH, personeli akademik dhe kërkimor sigurojnë që çdo kontratë a marrëveshje për publikimin ose përdorimin e rezultateve të kërkimit, të respektojë pronësinë intelektuale dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.

## NENI 21

### Shkeljet e integritetit në kërkimin shkencor

1. Përbën shkelje të etikës çdo lloj shkeljeje e integritetit në kërkimin shkencor.

1.2. Përbëjnë shkelje të rëndë të integritetit në kërkimin shkencor praktikat:

- a) fabrikimi;
- b) falsifikimi;
- c) plagjiatura;
- d) botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet ose riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit.

1.3. Përbëjnë shkelje të lehtë të integritetit në kërkimin shkencor praktikat:

- a) denigrimi i rolit të kërkuesve të tjerë në botime;
- b) ribotimi i plotë i pjesëve thelbësore të botimeve të veta më të hershme si botime të reja (autoplagjiatura), me qëllimin për t'i pretenduar të dyja botimet/publikimet njëkohësisht.

## Neni 22

### Veprimtaritë e jashtme

1. Veprimtaritë e jashtme të personelit të USH-së janë të lejueshme vetëm kur nuk bëhen pengesë për përmbushjen e detyrës dhe përgjegjësiwe zyrtare. Ai është i detyruar në cdo rast të respektojë parashikimet ligjore në fuqi.

## KREU V

### SHKELJET E ETIKËS

## NENI 23

### Sjelljet që përbëjnë shkelje të etikës

1 Konsiderohen si sjellje/ praktika/ veprime joetike që përbëjnë shkelje të etikës sjelljet, praktikat apo veprimet e mëposhtme:

- a. Veprime që dëmtojnë misionin dhe imazhin e USH-së apo të strukturave përbërëse të tij.
- b. Veprimet e dhunshme, kërcënimi, ushtrimi i dhunës fizike e psikike, sharjet, shpifjet, apo veprimet keqdashëse të çfarëdo lloji, ndaj çdo individi që ushtron veprimtarinë në USH.
- c. Pranimi i dhuratave, favoreve ose shmangie të humbjeve të mundshme, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat ka marrëdhënie, që ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.
- d. Veshja dhe paraqitja jo e rregullt dhe jo serioze e punonjësit.
- e. Plagjiatura.

- f. Përdorimi me keqdashje i emrit të USH-së;
- g. Veprimet që, me dashje, dëmtojnë infrastrukturën bazë dhe ndihmëse të USH-së.
- h. Përdorimi i paautorizuar i fondeve, infrastrukturës bazë dhe ndihmëse të USH-së.
- i. Përvetësimi pa të drejtë i fondeve, infrastrukturës bazë dhe ndihmëse të USH-së.
- j. Kopjimi gjatë provimit ose kopjimi i punës së tjetrit.
- k. Përdorimi i alkoolit dhe/ose substancave të ndaluara brënda ambienteve të USH-së.
- l. Çdo lloj veprimtarie apo sjellje tjetër që bie ndesh me dispozitat e këtij Kodi.

## **KREU VI**

### **VERIFIKIMI DHE SHQYRTIMI I SHKELJEVE TE ETIKËS**

#### **NENI 24**

##### **Këshilli i Etikës i USH-së**

1. Këshilli i Etikës i USH-së, është organ kolegjal, i cili krijohet dhe funksionon në përputhje me nenin 44, të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe nenit 29, të Statutit të USH-së.
2. Këshilli i Etikës promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, cënimin e integritetit dhe interesave institucionale si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale. Këshilli i Etikës shqyrton sjellje të ndryshme të personelit të USH-së ose të studentëve të USH-së si dhe vlerëson nëse ato përbëjnë shkelje të dispozitave të këtij kodi.

#### **NENI 25**

##### **Shqyrtimi dhe verifikimi i shkeljeve**

1. Verifikimi dhe shqyrtimi i shkeljeve të etikës dhe shkeljeve të integritetit në kërkimin shkencor bëhet nga Këshilli i Etikës së USH-së.
2. Anëtarët e Këshillit të Etikës për çdo rast duhet të deklarojnë konfliktin e interesit që mund të lindë gjatë verifikimit.
3. Verifikimi dhe shqyrtimi kryhen me integritet, në mënyrë të paanshme e gjithëpërfshirëse dhe pa cënuar saktësinë apo objektivitetin e procesit.
4. Procedurat e verifikimit kryhen në mënyrë konfidenciale në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, me qëllim mbrojtjen e personave të përfshirë në verifikim.
5. Procedurat e verifikimit dhe shqyrtimit të shkeljeve, pas përfundimit mund të bëhen publike, mbi bazën e kërkesës për të garantuar transparencën e verifikimit dhe vetëm nëse nuk çenojnë interesin e USH-së dhe të dhënat personale.
6. Individit, të cilit i atribuohet shkelja e etikës apo e integritetit në veprimtarinë akademike/kërkimit shkencor, njihet me detajet e plota të procesit dhe i sigurohet një proces i drejtë dhe i paanshëm, si dhe e drejta për të paraqitur provat dhe për t'u dëgjuar në lidhje me pretendimet e tij.

## NENI 26

### Paraqitja e kërkesës/ankesës

1. Këshilli i Etikës vihet në lëvizje mbi bazën e një kërkesë/ankese me shkrim. Kërkesa/ankesa anonime nuk do të pranohen për fillimin e procedurës për trajtimin e shkeljeve të dispozitave të këtij kodi. Këshilli i Etikës fillon një proces shqyrtimi në rastet e cënimit të imazhit të institucionit nga subjektet e këtij kodi, cënimit të dinjitetit, personalitetit dhe imazhit të çdo punonjësi të USH-së nëpërmjet fyerjeve e sharjeve publike në rrjete sociale ose me anë të shpërndarjes në adresat elektronike zyrtare të personelit të USH-së.

1.1. Në rastin kur kërkesë/ankesa i adresohet drejtëpërdrejtë Këshillit të Etikës, ajo depozitohet pranë protokollit të institucionit, i cili ia përcjell atë menjëherë Kryetarit të këtij organi.

1.2. Nëse kërkesa/ankesa i drejtohet ndonjë autoriteti tjetër, ky i fundit e përcjell kërkesën/ankesën për kompetencë pranë Këshillit të Etikës brenda 5 ditëve punë.

2. Të drejtën e kërkesës/ankesës e ka çdo pedagog i USH-së, çdo autoritet dhe organ drejtues i USH-së, studentët apo organet përfaqësuese të studentëve të USH-së.

## NENI 27

### Procedura për shqyrtimin dhe verifikimin e shkeljeve

1. Pas marrjes së kërkesës me shkrim, Kryetari thërret menjëherë mbledhjen e Këshillit të Etikës. Këshilli i Etikës shqyrton çështjen në seancë të mbyllur, ku duhet të jenë të pranishëm jo më pak se 4 anëtarë të tij në mënyrë që mbledhja të jetë e vlefshme.

2. Për mbledhjet e Këshillit të Etikës mbahet procesverbal nga sekretari i Këshillit. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Etikës të pranishëm në mbledhje.

3. Cilido i dyshuar për shkelje të dispozitave të këtij kodi prezumohet se nuk është shkelës, derisa të provohet e kundërta me vendim përfundimtar.

4. Këshilli i Etikës kur fillon procedurën e verifikimit dhe shqyrtimit të shkeljes, duhet të njoftojë me shkrim personin i cili pretendohet të ketë kryer shkeljen. Ai ka të drejtën të paraqesë me shkrim sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar, një afat jo më pak se 5 ditë punë nga data e njoftimit, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre, si dhe për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar.

3.1 Këshilli i Etikës duhet të shqyrtojë të gjitha rrethanat dhe faktet e nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe të mbledhë prova shkresore apo të pyesë dëshmitarë, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, dhe të dokumentojë çdo fazë të procedimit disiplinor me procesverbal.

3.2 Këshilli i Etikës thërret në seancë dëgjimore personin/personat kundër të cilit/cilëve është paraqitur kërkesa/ankesa. Personi ka të drejtë të paraqitet personalisht apo të përfaqësohet në mbledhjen përkatëse të Këshillit të Etikës ku ai është thirrur.

3.3 Personi kundër të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa ka të drejtë të paraqesë dokumente dhe materiale të tjera në lidhje me procedimin. Pretendimet e personit duhet të dëgjoen dhe të fiksohen në procesverbalin e mbledhjes. Personi i thirrur mund të paraqesë pretendimet edhe me shkrim, të cilat i bashkëngjiten dokumentacionit të dosjes së mbledhjes së Këshillit të Etikës.

3.4 Këshilli i Etikës mund të thërrasë në seancë dëgjimore edhe persona të tjerë, kur e gjykon të arsyeshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

3.5 Këshilli i Etikës shqyrton çështjen dhe pasi dëgjon personin përkatës a përfaqësuesin e tij, me votim të fshehtë, vendos me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

4. Këshilli i Etikës, si rregull, merr vendim brenda 90 ditëve nga paraqitja e kërkesë/ankesës, ku nëse ka ose nuk ka shkelje të etikës, në praktikën apo në sjelljen e paraqitur në kërkesë/ankesë.

4.1. Vendimi i Këshillit të Etikës është i formës së prerë.

5. Vendimi i Këshillit të Etikës për konstatimin e shkeljes përmban këto të dhëna:

- a. organin që ka marrë vendimin;
- b. identifikimin e punonjësit, të cilit i atribuohet ose jo shkelja dhe strukturën ku ai bën pjesë;
- c. shkeljen faktike të etikës, nëse është konstatuar;
- d. nenet e kodit të etikës që janë shkelur;
- e. arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve që janë bërë shkas për marrjen e vendimit;
- f. propozimin për llojin e masës disiplinore;
- g. datën e hyrjes në fuqi të vendimit, që është data e njoftimit të vendimit.
- h. nënshkrimet e të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në vendimarrje.

6. Brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit të Këshillit të Etikës, një kopje e vendimit i dorëzohet vetë personit/personave kundër të cilit/cilëve është drejtuar kërkesa/ankesa dhe një kopje i dorëzohet rektorit të USH-së dhe/ose Administratorit sipas varësisë së personelit, ku rekomandohet dhënia e masës disiplinore në rastet kur KE ka konstatuar se ka shkelje të normave të etikës të parashikuara në këtë kod.

6.1. Për komunikimin e vendimit zbatohen të gjitha rregullat e komunikimit formal, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe në Rregulloret e USH-së.

## NENI 28

### **Efekti i vendimit të Këshillit të Etikës për masat disiplinore**

1. Dhënia e masave disiplinore bëhet nga autoriteti përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi: Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH në fuqi”, Kodit të Punës, Statutit dhe Rregulloreve të USH-së.

## NENI 29

### **Masat disiplinore**

1. Këshilli i Etikës në vendimin e tij, mund të propozojë masat si vijon:
  - a. për personelin akademik, administrativ dhe joakademik
    - tërheqje vëmendjeje;
    - vërejtje me shkrim;
    - paralajmërim për largim nga detyra;
    - pezullim për një afat kohor 1 deri në 3 muaj;
    - zhvendosje nga një pozicion në një tjetër;
    - largim përfundimtar nga USH.
  - b. për studentët
    - tërheqje vëmendjeje
    - vërejtje me shkrim;
    - vërejtje me paralajmërim;

- pezullim për një semestër deri në një viti akademik;
- heqje e të së drejtës së studimit;

2. Caktimi i masave disiplinore bëhet në mënyrë progresive, me përjashtim të rasteve të kryerjes së shkeljeve të rënda apo të përsëritura.
3. Largimi nga detyra i personelit akademik bëhet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij dhe pas miratimit të dhënë nga Këshilli i Etikës dhe Komisioni *ad hoc* i ngritur nga Senati akademik në rastin e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të Ligjit. Personeli akademik, në rast të largimit nga detyra ka të drejtë të dëgjohet nga Senati akademik. (STATUTI, neni 49, pika 4, / neni 68 i Ligjit për AL).

### NENI 30 Ankimimi

1. Personeli akademik ka të drejtë të ankimojë vendimin e Këshillit të Etikës, duke paraqitur ankesë pranë Komisionit disiplinor *ad hoc*, që shqyrton si shkallë të dytë ankimin në kuadër të Senatit, 15 ditë nga data e nesërme e njoftimit sipas mënyrës së parashikuar në Kodin e Procedurave administrative.
2. Komisioni shqyrton ankesën e personelit akademik dhe në përfundim vendos të lërë në fuqi vendimin e Këshillit të Etikës ose të pranojë ankesën (në mënyrë të plotë ose të pjesshme).
3. Vendimi i Komisionit *ad hoc* për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me personelin akademik, mund të ankimohet në gjykatën kompetente.

### Neni 31

#### Dhënia e masave disiplinore

1. Rektori dhe/ose Administratori i USH-së, sipas rastit, mbi bazën e propozimit në Vendimin e Këshillit të Etikës ose të Komisionit *ad hoc*, miraton dhënien e masës disiplinore.
2. Urdhri për dhënien e masës disiplinore, i njoftohet personit të cilit i atribuohet shkelja brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e miratimit të tij.
2. Personi ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore ka të drejtën e ankimimit në gjykatën kompetente brenda afateve ligjore.
2. Një kopje e Urdhrit të masës disiplinore, i përcillet strukturës së burimeve njerëzore dhe regjistrohet në dosjen e personelit efektiv. Masa disiplinore shuhet me kalimin e afateve të përcaktuara në rregulloret në fuqi.

### NENI 32 Dispozita përfundimtare

Kodi i Etikës hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik dhe shpalljes nga Rektori i USH-së.

Shkodër, më 01.04.2026

KRYETARI I SENATIT  
Prof. Dr. Tomir Gjura